



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Raport Vjetor 2025





Përmbajtja

Fjala përshëndetëse	4-5
Fakte nga puna jonë në 2025	6-7
Programet tona	11-46
Puna jonë në media	47
Projektet	48
Mbështetësit kryesorë dhe kontraktorët tanë	49
Financat	50

Kush Jemi


Partnerët Shqipëri është një OJF shqiptare e pavarur, e themeluar në vitin 2001, që mbështet shoqërinë civile dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndër-sektorial me qëllim forcimin e institucioneve demokratike dhe avancimin e zhvillimit ekonomik.

Partnerët Shqipëri është anëtare e Kodit të Standardeve të Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri, dhe luan rolin e Sekretariatit të Kodit përmes Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Partnerët Shqipëri është anëtare e Partners Network, një partneritet i 19 organizatave të pavarura në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore, Afrikë e Lindjen e Mesme, të cilat punojnë për një ndryshim paqësor e demokratik.

Partnerët Shqipëri është anëtare edhe e disa rrjeteve të tjera globale, rajonale dhe evropiane si BCSDN, ECAS, DIESIS, ANNA LINDH, WINGS, Alliance for Peacebuilding, CHANCE – Civil Hub Against organised Crime in Europe, etj.

www.partnersalbania.org





Fjala Përshëndetëse

Juliana Hoxha
Drejtores



Viti 2025 e përballi shoqërinë civile në Shqipëri me një realitet të ri dhe kompleks. Zhvillimet në nivel global riformësuan peizazhin politik dhe financiar në të cilin veprojnë organizata si e jona. Ndërprerja e menjëhershme e asistencës së Shteteve të Bashkuara uli ndjeshëm fondet e disponueshme për sektorin jofitimprurës, ndërkohë që prioritetet gjeopolitike në Evropë u orientuan gjithnjë e më shumë drejt çështjeve të sigurisë. Në të njëjtën kohë, shoqëria civile në Shqipëri përjetoi një valë sulmesh publike dhe dezinformimi që sfidoi besueshmërinë e organizatave që punojnë për promovimin e vlerave demokratike dhe pjesëmarrjes qytetare. Për Partnerët Shqipëri, ky kontekst kërkoi reflektim të kujdesshëm dhe përshtatje. Përgjegjësia jonë e parë ishte të ruanim stabilitetin e organizatës dhe të mbeteshim një partner i besueshëm për komunitetet dhe organizatat me të cilat bashkëpunojmë. Në të njëjtën kohë, ishte e nevojshme të rishqyrtonim mënyrat më të përshtatshme për të mbështetur shoqërinë civile në një moment kur si mjedisi i veprimit, ashtu edhe pritshmëritë ndaj sektorit po evoluojnë me ritme të shpejta.

Ajo që mbeti e qartë gjatë gjithë vitit ishte rëndësia e mbajtjes së shoqërisë civile të lidhur ngushtë me rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritimit evropian. Hapja e negociatave të anëtarësimit krijoi një shtysë të re për reformat dhe përafrimin e legjislacionit me standardet evropiane. Këto zhvillime përforcuan rëndësinë që ndryshimet ligjore dhe institucionale të pasqyrojnë standardet e Bashkimit Evropian, duke mbetur njëkohësisht të ndjeshme ndaj realiteteve të shoqërisë shqiptare.

Gjatë gjithë vitit, ekipi ynë mbeti i angazhuar aktivisht në dialogun e politikave dhe në proceset legjislative që lidhen me këtë agjendë. Ne ofruam opinione ligjore, rekomandime dhe kontribute teknike mbi projektligje dhe dokumente strategjike që ndikojnë në mjedisin mundësues për shoqërinë civile dhe në qeverisjen demokratike. Këto kontribute trajtuan fusha të tilla si rregullimet fiskale që prekin organizatat jofitimprurëse, dispozitat ligjore që lidhen me kuadrin për parandalimin e pastrimit të parave, ligjin për vullnetarizmin, bilbilfryrësin, lobimin si edhe reforma më të gjera në administratën publike. Përmes këtyre proceseve, ne vazhduam të avdokojmë për legjislacion që forcon transparencën, llogaridhënien dhe pavarësinë e aktorëve të shoqërisë civile.

Angazhimi ynë u shtri gjithashtu përtej proceseve në nivel kombëtar. Përmes dialogut me institucionet evropiane dhe pjesëmarrjes në iniciativa rajonale, ne punuam për të siguruar që perspektivat e shoqërisë civile shqiptare të dëgjohen në diskutimet më të gjera mbi reformat demokratike dhe procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Pjesëmarrja në dialogje politikash dhe shkëmbime në Bruksel dhe në rajon krijoi mundësi për të ndarë përvojën nga Shqipëria dhe për të ndërtuar aleanca më të forta me partnerë që përballen me sfida të ngjashme.


Në të njëjtën kohë, ne vazhduam të mbështesim iniciativa që sjellin inovacion dhe energji në komunitetet lokale. Gjatë vitit ne bashkëpunuam me organizata, sipërmarrës dhe nisma komunitare që po zhvillojnë përgjigje praktike ndaj sfidave sociale dhe mjedisore. Mbështetja e ideve të tyre, forcimi i kapaciteteve dhe krijimi i mundësive për bashkëpunim mbetet një nga dimensionet më kuptimplota të punës sonë.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i punës sonë ka qenë forcimi i besimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile, institucioneve dhe qytetarëve. Përmes kërimit, platformave të dialogut dhe iniciativave për zhvillimin e kapaciteteve, ne inkurajua procese vendimmarrëse më të hapura dhe më pjesëmarrëse. Përvoja jonë vazhdon të tregojë se reformat e qëndrueshme kërkojnë jo vetëm institucione të forta, por edhe qytetarë aktivë dhe të mirëinformuar.

Duke reflektuar mbi vitin 2025, është e qartë se sfidat me të cilat përballlet shoqëria civile nuk janë të përkohshme. Ato janë pjesë e një transformimi më të gjerë në mënyrën se si evoluojnë institucionet demokratike, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe angazhimi qytetar në rajonin tonë dhe më gjerë. Megjithatë, këto sfida rikonfirmojnë rëndësinë e punës sonë. Shoqëria civile luan një rol thelbësor në mbrojtjen e vlerave demokratike, në promovimin e llogaridhënies dhe në sigurimin që politikat publike t'u përgjigjen nevojave të qytetarëve.

Unë i jam thellësisht mirënjohëse ekipit të Partnerëve Shqipëri, përkushtimi dhe profesionalizmi i të cilit vazhdojnë të udhëheqin punën tonë edhe në kohë sfidash. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj partnerët, donatorët dhe të gjitha organizatat dhe individët që ndajnë me ne angazhimin për forcimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes qytetare në Shqipëri.

Jam besimplotë që sëbashku do të vazhdojmë të punojmë për të siguruar që rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian të shoqërohet me institucione më të forta, qytetarë aktivë dhe një shoqëri civile dinamike që kontribuon në formësimin e së ardhmes së vendit.



FAKTE NGA PUNA JONË NË 2025

Aktivitetet dhe pjesëmarrësit

Ditë veprimtari

348



Pjesëmarrës të drejtpërdrejtë

2463



Aktivitate

316

Trajnime
Mentorime
Sesione Informuese
Evente rrjetëzimi
Konferenca ndërkombëtare &
Evente publike
Konkurse
Evente dhurimi Live
Tryeza diskutimi
Vizita studimore

Lektorë & Ekspertë të Angazhuar

76



Ndjekësit dhe angazhimi në rrjetet sociale



Ndjekës

46K

3K ndjekës të rinj në 2025

Audienca e arritur

2.1M

400% më shumë se viti paraardhës

Vizita

89K

145% më shumë se viti paraardhës

Angazhim

8K

186% më shumë se viti paraardhës

Projektet dhe partnerët


Projekte

11



Partnerë zbatues

29



Donatorë


6

Publikimet dhe daljet në media

Publikime

27

Studime Raporte
Revista Broshura
Buletine informative



Artikuj e Dalje në Media

45+



Përfaqësimi

Kombëtar

Rajonal

Global

Partnerët Shqipëri, anëtare e rrjeteve:

PARTNERS NETWORK
RRIJETI BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE (BCSDN)
EUROPEAN CITIZEN ACTION SERVICE (ECAS)
DIESIS
ANNA LINDH
WINGS
ALLIANCE FOR PEACEBUILDING
CHANCE - CIVIL HUB AGAINST ORGANISED CRIME IN EUROPE



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



FUSHAT TONA PROGRAMATIKE


- ▶ Mjedis mundësues dhe zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë civile
- ▶ Sipërmarrja dhe Inovacioni Social
- ▶ Aktiviteti filantropik dhe infrastruktura mbështetëse
- ▶ Qeverisja me pjesëmarrje transparente dhe e përgjegjshme

ÇFARË OFROJMË

- ▶ Ndërtim dhe fuqizim kapacitetesh
- ▶ Mbështetje financiare
- ▶ Advokim dhe punë kërkimore

PËRFITUESIT TANË

- ▶ Shoqëria civile
- ▶ Sipërmarrësit socialë dhe novatorë
- ▶ Institucionet shtetërore dhe politikë-bërësit





Gjatë eventit kombëtar të lancimit të programit të ri katërvjeçar të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile (2025–2029), mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Partnerët Shqiptarë në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, dhe Lëvizjen Evropiane Shqiptare. Eventu u zhvillua si pjesë e aktiviteteve të Javës së Shoqërisë Civile 2025. Tiranë, 20 qershor 2025

Ndërtim Kapacitetesh

4 Programe

- Akademia e OJF-ve
- Akademia e Manaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të (për herë të parë në Shqipëri)
- EU Aquis - Angazhimi dhe Roli i OSHC-ve në Procesin e Integrimit të Vendlut në BE
- Programe Trajnimi Sipas Nevojave

Ditë Trainimi dhe mentorimi

51

Tema të trajtuara

25

Lektorë dhe ekspertë të ftuar

25

Përfitues

385

Temat e trajtuara

Kuadri Ligjor dhe Fiskal për OJF-të

- Bazat e Sektorit Jofitimprurës: Kuptimi i kuadrit ligjor dhe qeverisës fiskal
- Kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve në Shqipëri
- Procedura e Përfshirjes nga TVSH për projektet me financim të donatorëve të huaj në Shqipëri

Manaxhimi i Brendshëm Financiar

- Manaxhimi financiar: Buxheti dhe kontabiliteti; Detyrimet dhe raportimet në shtet
- Planifikimi Strategjik Financiar: Buxheti për një ndikim në misionin e organizatës
- Qeverisja Financiare: Krijimi i praktikave të qarta dhe transparente financiare brenda organizatës
- Mjetet e Manaxhimit Financiar: software-e, automatizim dhe analitike
- Prokurimi, Kontrolli Financiar dhe Manaxhimi i Rrezikut

Ngritja e Fondeve dhe Diversifikimi i të Ardhurave

- Diversifikimi i të Ardhurave: Nisma të gjenerimit të të ardhurave
- Ngritja e fondeve: Grante, fonde publike, sektori privat
- Rëndësia e platformave Crowdfunding si formë alternative financimi – platforma Smile.al
- Sigurimi i mbështetjes financiare përmes grantëve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së

Manaxhimi i Granteve dhe Projekteve

- Manaxhimi Efektiv i Granteve: Pajtuueshmëria dhe raportimi për iniciativat e financuara nga grantet

Advokasi, Mobilizim dhe Pjesëmarrje Qytetare

- Advokacia dhe lobimi
- Mobilizimi i mbështetësve. Krijimi i rrjeteve dhe koalicionëve
- Fuqizimi i shoqërisë civile për pjesëmarrje dhe ndikim në proceset buxhetore
- Qeverisja me pjesëmarrje

Komunikim dhe Transformim Digjital

- Komunikimi strategjik i OJF-ve në epokën digjitale
- Rritja e kompetencave digjitale dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale për OSHC-të

Planifikim Strategjik dhe Zhvillim Organizativ

- Planifikimi strategjik
- Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme
- Metodologjitë e Matjes së Ndikimit: Komunikimi efektiv i ndikimit social të organizatës

Integrimi Evropian dhe Shoqëria Civile

- Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe roli i OJF-ve në këtë proces
- Partneritet për Evropën: Roli i shoqërisë civile, institucioneve akademike dhe aktorëve kyç në procesin e integrimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendlut

FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË SHOQËRISË CIVILE



Shërbime mbështetëse, informim dhe rrjetëzim

Kërkesa për informacion nga OJF-të, të adresuara

517

291 Organizata dhe aktivistë të asistuar

Takime dhe Forume Lokale

25

567 Pjesëmarrës: OSHC, Aktivistë dhe grupe interesi

Rregjistrime në Direktorinë e OJF-ve online

184

Njoftime të ndara me sektorin

309

Thirrje për Projekt Propozime, Njoftime për Konsultime Publike, Mundësi Trajnimi, Evente, Studime, etj.

Qendra Burimore Lëvizëse

6 qytete

8 takime

202 pjesëmarrës (OSHC, të rinj aktivistë, përfaqësues të institucioneve publike)

Organizatorë dhe mbështetës të
Java e Shoqërisë Civile 2025

59 organizata

172 aktivitete në të gjithë Shqipërinë (21 aktivitete të mbështetura financiarisht)

12 qarqe, 24 bashki

Java e
Shoqërisë
Civile
2025



Co-funded by
the European Union

Sida

Regional Security
Management Platform

PARTNERS

National Endowment for
Democracy

RESILIENT VOICES

Nga Konferenca "Zëra Qëndrestarë: Shoqëria Civile e Ballkanit Perëndimor në një Botë në Ndryshim", zhvilluar në 1 Tetor 2025 në Tiranë. Gjatë konferencës u nënshkrua edhe një Deklaratë e Përbashkët, e cila nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, advokimit të përbashkët dhe mbështetjes së qëndrueshme për shoqërinë civile, si elemente kyçe për forcimin e demokracisë dhe procesit të integrimit evropian në Ballkanin Perëndimor.

ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE PËR NJË MJEDIS MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me mjedisin mundësues për shoqërinë civile



Dialog i Politikave të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor në Bruksel, më 24–26 shkurt 2025, ku si pjesë e rrjetit BCSDN u takuam me institucionet e BE-së, rrjetet e shoqërisë civile dhe partnerët rajonalë për të advokuar për një proces zgjerimi më gjithëpërfshirës, demokratik dhe të bazuar në të drejtat, me një fokus të fortë në hapësirën qytetare, pjesëmarrjen kuptimplotë të shoqërisë civile dhe mbrojtjen e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.



Takime strategjike në Bruksel në 23-24 qershor 2025 në kuadër të Dialogut për Planin e Rritjes së Vendit, si pjesë e një delegacioni shqiptar me përfaqësues nga shoqëria civile, Kuvendi dhe Këshilli i Investimeve, duke mundësuar takime strategjike me DG ENEST, DG EXPO të Parlamentit Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (EESC), si dhe Misionin e Shqipërisë pranë BE-së.



Letër dërguar institucioneve tatimore dhe donatore mbi shqetësimet lidhur me zbatimin e ndryshimeve fiskale për projektet e financuara me grante nga donatorë të huaj, për të cilat aplikohet TVSH zero.



Opinion ligjor mbi projektligjin për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Parlamentit.



Opinion Ligjor mbi ndryshimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar”.



Letër e Hapur mbi vlerësimin e Udhërrëfyesit për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 – 2023 dhe hartimin e Udhërrëfyesit për periudhën 2024 –2027.



Letër publike institucioneve të Bashkimit Evropian, shteteve anëtare të BE-së dhe organizmave të tjerë mbështetës të shoqërisë civile, mbi situatën shqetësuese të kurrjes së mbështetjes financiare ndaj sektorit.



Analizë dhe Rekomandime për Ligjin për Vullnetarizmin.



Kontribut për Strategjinë e BE-së për Shoqërinë Civile, si pjesë e Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.



Dialog konstruktiv me Komisioneren Marta Kos mbi rolin thelbësor të shoqërisë civile në procesin e integritimit në BE dhe nevojën për standarde të matshme për hapësirën qytetare, mekanizma më të fortë pjesëmarrjeje dhe akses më të lehtë në financim për të mbështetur reforma gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Bruksel, nëntor 2025.



Takimi i dytë i Komitetit të Përbashkët Konsultativ BE–Shqipëri (JCC), zhvilluar më 21 nëntor 2025 në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) në Bruksel. JCC shërben si një platformë e strukturuar për përfaqësuesit e shoqërisë civile nga BE-ja dhe Shqipëria për të ndjekur procesin e anëtarësimit, për të shkëmbyer mendime mbi zhvillimet kryesore dhe për të ngritur çështje që lidhen me rrugën e vendit drejt anëtarësimit në BE.



Firmëtarë të deklaratës së përbashkët të nënshkruar nga 45 organizata të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor, Ukraina dhe Moldavia, drejtuar institucioneve të Bashkimit Evropian. Në deklaratë kërkohet që zgjerimi i BE-së të trajtohet si prioritet strategjik dhe buxhetor në Kuadrin Shumëvjeçar Financiar të BE-së 2028–2034, duke siguruar fonde të mjaftueshme dhe të parashikueshme për procesin e integritimit.



MEGAPHONE 2025, event i kryesor vjetor i TechSoup Europe, dedikuar transformimit digjital, teknologjisë qytetare dhe inovacionit me ndikim social. Event i bëri bashkë drejtues të shoqërisë civile, ekspertë të teknologjisë dhe profesionistë nga e gjithë Evropa për të eksploruar mënyrat se si mjetet digjitale, inteligjenca artificiale dhe të dhënat mund të forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave, besimin publik dhe angazhimin qytetar, një hapësirë e rëndësishme për ndarjen e përvojave si dhe për analizimin e trendeve të reja në teknologjinë që mbështet sektorin jofitimprurës.



Raporti i Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.




Kontribut në hartimin e Raportit Rajonal të Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.



Dëftesat mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt Anëtarësimit në Bashkimin Evropian:

- Vlerësimi i Kapitullit 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)
- Vlerësimi i Kapitullit 24 (Drejtësia, Liria, Siguria)
- Vlerësimi i Kriterit Politik



Vlerësimi i mjedisit të favorshëm për barazinë gjinore dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të grave në Shqipëri.



Kontribut në hartimin e raportit "Këndvështrimi që mungon për barazinë gjinore në Ballkanin Perëndimor".



Kontribut në hartimin e raportit "Mbështetja e donatorëve, hapësira qytetare dhe e ardhmja e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor".




Raport përmbljedhës i fjalimeve dhe diskutimeve të zhvilluara gjatë Konferencës Rajonale "Zëra Qëndrestarë: Shoqëria Civile e Ballkanit Perëndimor në një Botë në Ndryshim", zhvilluar në 1 Tetor 2025 në Tiranë.



Takimi kombëtar mbi Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP), i organizuar më 27 nëntor, një hapësirë dialogu mbi sfidat në rritje të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike në Shqipëri dhe nevojën për një reagim më efektiv institucional dhe ligjor.



Seri materialesh informuese rreth Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP).



CHALLENGE FUND

FINANCE FORWARD:

ZHBLLOKIMI I KAPITALIT PËR RRITJEN E STARTUPEVE

EVENT RRJETËZIMI

JAVËS GLOBALE TË SIPËRMARRJES 2025



JAVË
GLOBALE E
SIPËRMARRJES
SHQIPERË 2025

NDËRTOJMË SË BASHKU

ANËS

Implemented by

giz

Realizuar nga

Sweden
Sverige

PARTNERSHIP

Sërish në 2025, për të tretin vit rradhazi, ishim mbështetës e partnerë të Javës Globale të Sipërmarrjes – GEW Albania 2025, me aktivitete në kuadër të Challenge Fund, si dhe me pjesëmarrje në panele diskutimi mbi sipërmarrjen sociale dhe inovacionin.

Eventi **"Finance Forward: Zhbllokimi i kapitalit për rritjen e startupeve"**, mbledhi politikëbërës, institucione financiare, investitorë, partnerë ndërkombëtarë dhe themelues startup-esh për të diskutuar mbi instrumentet alternative të financimit, përfshirë crowdfunding, financimin e qëndrueshëm dhe programet mbështetëse.

FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË SIPËRMARRËSVE SOCIALE DHE NOVATORË



Ndërtim Kapacitetesh

3 Programe Inkubimi

- Programi i bizneseve të gjelbërta
- Challenge Fund EU4Innovation
- Manaxhimi i mbetjeve të qelqit

Ditë Trajnim

22

Ditë Mentorim

188

Ekspertë dhe mentorë

25

Vizita Studimore Ndërkombëtare

3 ⁵³ pjesëmarrës
(startupe, investitorë,
përfaqësues të
insitucioneve publike)

Përfitues

259

Informim dhe Rrjetëzim

Sesione informuese rajonale

19 ⁴³¹ Sipërmarrës, startupe dhe individë me
ide biznesi të informuar rreth Konkursit
të Bizneseve të Gjelbërta dhe Thirrjes për
Propozime të Challenge Fund

Panair

3 ³⁰ Sipërmarrje dhe biznese të mbështetura nga
Partnerët Shqipëri përmes programeve të
sipërmarrjes u promovuan në Infest 2025,
Future2Tech, dhe Panairin Ndërkombëtar të
Tiranës

Evente Shkëmbimi dhe Rrjetëzimi

3 ⁶⁰ Sipërmarrës dhe aktorë mbështetës të
ekosistemit

Vizitë me gazetarët

1 ⁹ Gazetarë ishin pjesë e vizitave në 3 startupe
të mbështetura përmes Challenge Fund, duke
i promovuar ata përmes artikujve në median
e shkruar dhe emisioneve televizive

PËR NJË TREG PUNE NË DOBI TË RINISË SHQIPTARE



RisiAlbania është një projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga një konsorcium i udhëhequr nga HELVETAS Swiss Intercooperation, në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Që prej nisjes së tij në vitin 2013, projekti ka synuar të përmirësojë punësimin e të rinjve në Shqipëri përmes forcimit të rritjes së sektorit privat, përmirësimit të shërbimeve të orientimit në karrierë dhe ndërmjetësimit për punësim, si dhe zgjerimit të programeve të trajnimeve për aftësi që i përgjigjen kërkesave të tregut.

Gjatë më shumë se një dekade të zbatimit të tij, RisiAlbania ka gjeneruar një ndikim të rëndësishëm dhe të matshëm në tregun e punës në Shqipëri. Projekti ka mundësuar punësimin e më shumë se **19,000** vajzave dhe djemve të rinj, duke i ndihmuar të kenë akses në mundësi më të mira dhe më gjithëpërfshirëse punësimi. Ai gjithashtu ka mbështetur mbi **12,000** të rinj në përvetësimin e aftësive që i përgjigjen kërkesave të tregut, veçanërisht në sektorë me potencial të lartë rritjeje si TIK-u, turizmi dhe agrobiznesi.

Përveç kësaj, më shumë se **100,000** të rinj kanë përfituar nga shërbime të përmirësuara të orientimit në karrierë, duke u mundësuar të bëjnë zgjedhje të informuara për karrierën dhe të kalojnë më me efektivitet nga arsimi në punësim. Përmes ndërhyrjeve të tij për zhvillimin e sektorit privat, projekti ka ndihmuar gjithashtu bizneset të rriten dhe të përmirësojnë produktivitetin, duke gjeneruar mbi **3.9 milionë** euro të ardhura shtesë për kompanitë.

Përtej rezultateve të drejtpërdrejta, RisiAlbania ka kontribuar në përmirësime sistemike të ekosistemit të tregut të punës në Shqipëri. Këto përfshijnë ngritjen dhe forcimin e shërbimeve të orientimit në karrierë në universitete dhe bashki, përmirësimin e shërbimeve të përputhjes së vendeve të punës me kandidatët dhe të ndërmjetësimit për punësim, si dhe zhvillimin e programeve inovative të trajnimit joformal të përafuara me nevojat e tregut të punës.

Në tërësi, RisiAlbania ka ndihmuar në ndërtimin e një sistemi punësimi më gjithëpërfshirës dhe të orientuar nga tregu, duke nxitur bashkëpunim më të fortë ndërmjet sektorit privat, ofruesve të trajnimeve dhe institucioneve publike. Puna e tij ka kontribuar në krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës, përmirësimin e punësueshmërisë së të rinjve shqiptarë dhe forcimin e institucioneve të tregut të punës në të gjithë vendin.



Vizitë në Albaponik, një nga startupet e mbështetura përmes Challenge Fund | EU4Innovation. Albaponik kultivon perime jeshile të freskëta dhe me cilësi të lartë përmes metodës hidroponike. 30 prill 2025



Gjatë eventit lançues të iniciativës “reuseAglass” mbështetur përmes Programit të Inkubimit dhe Granteve për Manaxhimin e Mbetjeve të Qelqit si pjesë e Lab of Tomorrow. Eventi bëri bashkë inovatorë, advokues mjedisorë, artistë e komunitete, për të treguar se ndryshimi fillon atje ku komuniteti dhe kreativiteti takohen me një qëllim të përbashkët: për t’i dhënë qelqit një jetë të dytë! Tiranë, 25 tetor 2025

3 Skema mbështetjeje me grante

Challenge Fund

EU4INNOVATION



Sverige

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Thirrje për propozime e hapur gjatë 2025

1

Vlera totale e kontraktuar

311,936 Euro

Startupe të mbështetura

17

Konkursi I BIZNESEVE TË GJELBËRTA

Sipërmarrje të mbështetura

4

Vlera totale e kontraktuar

41,335 Euro

Programi i Inkubimit dhe granteve për manaxhimin e mbetjeve të qelqit si pjesë e Lab of Tomorrow

EU 4 CIRCULAR ECONOMY AND LIVABLE CITIES



Implemented by

PARTNERS ALBANIA
FOR SOCIAL AND ENVIRONMENTAL

Ekipe biznesesh të mbështetura financiarisht

3

Vlera totale e kontraktuar

206,776 Euro



DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË

“

Challenge Fund ka luajtur një rol kyç për të ndihmuar Bliss që të avancojë misionin e bërjes së mbështetjes për shëndetin mendor të aksesueshme, të përshtatshme dhe pa stigma. Në një fazë kritike të hershme, Challenge Fund na mundësoi të ndërtojmë dhe testojmë zgjidhje të dizenuara për komunitetet që shpesh neglizhohen nga sistemet tradicionale të shëndetit mendor. Me këtë mbështetje, arritëm të vendosim prioritet mbi ndikimin, të investojmë në besim dhe të dizenojmë përkujdes që realisht i përgjigjet njerëzve aty ku janë – në gjuhën, kulturën dhe përvojën e tyre personale. Besimi i Challenge Fund në inovacionin e udhëhequr nga qëllimi na ka ndihmuar të transformojmë misionin tonë në një mbështetje reale dhe me kuptim për njerëzit që kanë më shumë nevojë.

Jona Doda
Themeluese e “Bliss”

“

Pjesëmarrja në Programin e Inkubimit dhe Manaxhimit të Granteve për Riciklimin e Qelqit forcoi ndjeshëm kapacitetet profesionale dhe organizative të ekipit Circular Art Hub, duke na ndihmuar të përmirësojmë mënyrën e planifikimit, implementimit dhe manaxhimit të projekteve në fushën e riciklimit dhe ekonomisë qarkulluese, sipas standardeve europiane. Partnerët Shqipëri na ofruan mbështetje të vazhdueshme në të gjitha fazat, veçanërisht në raportimin narrativ dhe financiar, duke e kthyer procesin në një mundësi reale rritjeje. Falë këtij bashkëpunimi, kemi rritur edhe vizibilitetin e punës sonë përmes mundësimit të pjesëmarrjes në Tirana International Fair dhe EU4GreenGen. Jemi mirënjohës për këtë bashkëpunim efektiv dhe profesional dhe shprehim dëshirën për vijimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Erinda Hametaj
Manaxhere Projekti e Ekipit Circular Art Hub

“

Të merrja pjesë në Konkursin e Bizneseve të Gjelbërta dhe për më tepër të isha fituese e grantit për bizneset e gjelbërta, ishte një mundësi që ka patur një ndikim të madh në zhvillimin e biznesit tim. Ky grant ishte shtesa kryesore në hapjen e dyqan-punishtes së re, që tashmë ka marrë formë. Gjithashtu, pata kënaqësinë të marr pjesë në fazën rajonale të konkursit për bizneset e gjelbërta, ku takova njerëz me pasione të ngjashme dhe ndava eksperiencë frymëzuese mbi praktikën e qëndrueshme. Ishte një mundësi e vlefshme për të mësuar dhe lidhur kontakte, që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e biznesit tim.

Alketa Muharemi
Themeluese e “Jorean Handmade”



Funded by
the European Union

implemented by



PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT



in cooperation with



INTERNATIONAL CONFERENCE FROM ILLICIT GAINS TO PUBLIC GOOD: THE FUTURE OF CONFISCATED ASSETS

TIRANA, ALBANIA FEBRUARY 12TH, 2025



Konferenca ndërkombëtare "Nga Fitimet e Paligjshme të e Mira Publike: E Ardhmja e Aseteve të Konfiskuara" organizuar nga Partnerët Shqipëri dhe organizata italiane Libera Contro le Mafie, Tiranë, 12 shkurt 2025. Konferenca shënoi përmbylljen e projektit TWIST: Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri, i cili ka kontribuar në forcimin e një modeli të qëndrueshëm për manaxhimin dhe ripërdorimin e asetëve të konfiskuara në Shqipëri.

ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH SIPËRMARRJES DHE INOVACIONIT SOCIAL

Kontribut në agjendën rajonale lidhur me sipërmarrjen sociale



Balkan Green Ideas 2025, edicioni i 14-të i konkursit rajonal të ideve të gjelbërta me ndikim mjedisor, social dhe ekonomik. Shqipëria u përfaqësua nga tre sipërmarrës, fitues të Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2025 organizuar nga Partnerët Shqipëri.



Eventi rajonal **CEE4Impact Day**, i mbajtur në Budapest më 8–9 nëntor, një mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe mundësive të bashkëpunimit mes aktorëve të ekosistemit të sipërmarrjes dhe investitorëve evropianë me ndikim, për mbështetjen e zhvillimit të sipërmarrjes lokale drejt zgjerimit dhe qëndrueshmërisë.



Impact Week 2025 – “Brighter Together”, zhvilluar në Malmö më 18–20 nëntor, një mbledhje e aktorëve globalë të filantropisë, financave dhe inovacionit social, për të shqyrtuar modele dhe praktika që mbështesin zhvillimin dhe zgjerimin e ekonomisë sociale, duke krijuar mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar dhe shkëmbim njohurish.



Seri takimesh rajonale mes organizatave partnere në zbatimin e iniciativës **CREASSE**, me synim zhvillimin e iniciativave të Ekonomisë Sociale dhe Solidare (SSE) si një forcë transformuese që mund të sjellë një ndryshim sistemik dhe pozitiv veçanërisht në zonat rurale.



Eventi online **“Zëra që Frymëzojnë – Çfarë ju Shtyu të Bëheni Sipërmarrës?”** mbajtur më 18 qershor 2025, ku 10 folës ndanë rrugëtimin e tyre në ngritjen e sipërmarrjeve me fokus social, duke sjellë sëbashku sipërmarrës aspirantë, sipërmarrës me eksperiencë, dhe aktorë kryesorë të SSE. Sipërmarrësit nga Shqipëria, Sentiljana Marku (Mjedrat e Danjës) dhe Rakip Belishaku (Rinora Handmade), ndanë rrugëtimet e tyre me impakt në bujqësinë e qëndrueshme dhe inovacionin miqësor me mjedisin, së bashku me sipërmarrës nga Qipro, Hungaria, Italia dhe Spanja.



Raporti i Parë i Vlerësimit të Ekosistemit të Startup-eve në Shqipëri. Gjetjet shërbejnë si udhërrëfyes për të thelluar mbështetjen ndaj startup-eve shqiptare dhe për të krijuar një mjedis ku idetë inovative zhvillohen në biznese të qëndrueshme. Studimi u mbështet nga Challenge Fund | EU4Innovation.



Raporti **“Hapa të rinj për Tranzicionin e Dyfishtë të Sipërmarrjeve Sociale në sektorin e Artit dhe Artizanatit”** përqendrohet në sistemet e ngritura për Sipërmarrjet Sociale dhe ato të Arsimit dhe Formimit Profesional / të Vazhdueshëm, duke i mbështetur këto sisteme në të gjithë Bashkimin Evropian dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor.



Broshurë e sipërmarrjeve sociale të ngritura dhe mbështetura përgjatë viteve përmes Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta në Shqipëri, si dhe impakti i tyre në punësim dhe ekonomi.



Fushatë ndërgjegjëse online dedikuar rritjes së ndërgjegjësimin dhe thellimit të kuptimit mbi Ekonominë Sociale dhe Solidare.



Në Forumin e Rise, një nga eventet e GEW2025, pjesë e panelit advokues dedikuar sipërmarrjes sociale në Shqipëri, ku theksuam ndër të tjera nevojën urgjente për rishikimin e Ligjit për Sipërmarrjen Sociale, si dhe rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis aktorëve të ekosistemit për mbështetje të qëndrueshme.



Nga vizita e Komisioneres Evropiane për Zgjerimin, Znj. Marta Kos në sipërmarrjen sociale **Tradita ime Artizanale** në Elbasan, një nga nismat e mbështetura përmes projektit TWIST, me kontribut në punësimin e grave dhe vajzave nga komunitete vulnerabël dhe ruajtjen e trashëgimisë e vlerave kulturore tradicionale.

Dhurimet sipas formës


Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**, **Fushatave** dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

582 dhurime përmes Eventeve

180 dhurime në formë të Drejtëpërdrejtë


104,260 dhurime përmes Fushatave

Vlera e dhurimeve sipas formës



Qëllimi i dhurimit

- Shëndetësi
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Aktivitetet humanitare me bazë fetare
- Tjetër



Fushata për ngritjen e fondeve

414
Thirrje për Dhurime

49
Fushata përmes platformave Crowdfunding

2
Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social*

167
Fushata përmes Medias Sociale & Platformave Crowdfunding

32
Megafushata

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

99.71% e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri



1014
artikuj në media që shërbejnë si burim informacioni në lidhje me rastet e dhurimeve

Hapësirë e dedikuar mbështetjes së nismave komunitare dhe kauzave sociale



PARTNERËT



#Rrathë Dhurues
Shqipëri

Iniciativë e Re

MBËSHTETJE FINANCIARE

Që prej vitit 2018, Partnerët Shqipëri ka organizuar shtatë evente “Rrathë Dhurues Shqipëri”, përmes të cilave janë mbështetur 22 nisma komunitare në fusha si edukimi, promovimi i të drejtave të njeriut, aktivizmi rinor, mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i turizmit, shërbimet psiko-sociale për fëmijët në nevojë, si dhe përmirësimi apo krijimi i hapësirave publike për moshën e tretë, etj. Konceptuar në formatin e dhurimit live, “Rrathë Dhurues” mbledh çdo vit në një hapësirë të përbashkët individë nga fusha dhe profile të ndryshme, të cilët kontribuojnë me ekspertizë, kohë dhe burime financiare për të mbështetur drejtpërdrejt kauzat konkrete që prezantohen në event, prej të cilave përfitojnë komunitete të nevojë.



#RrathëDhurues
Shqipëri

1 event “RRATHË DHURUES” në 2025, edicioni i 7-të

45 dhurues (Individë dhe Entitete)

2,214,628 Kontribut i dhuruar*

* Vlera në Lekë i referohet kontributeve monetare, materiale dhe konsulencës falas të ofruar gjatë eventit

3 nisma të mbështetura në 2025

Bankina që dëgjon


Një ide që kthen hapësirat publike të Matit në vende që flasin! Organizata zbatuese: “Fondacioni Së Bashku”

MALGA – Mal, Gur, Ajër


Një mision për të ringjallur Parkun Kombëtar “Lurë–Mali i Dejës”, të dëmtuar ndër vite. Organizata zbatuese: “Network Albania”

Krijuesit e rinj korçarë të së ardhmes


Rreth 50 të rinj të moshës 14–22 vjeç në Korçë të trajnuar në kampe teknologjie për të rinjte do të kthejnë idetë e tyre të biznesit në produkte konkrete! Organizata zbatuese: Fondacioni Komunitar “Korçarët Ndhimojmë Korçarët”



Gjatë prezantimit të tre nismave në eventin Rrathë Dhurues 2025



Në Parkun “Nëna Geraldinë” në Bashkinë Mat është vendosur “Bankina që dëgjon”, një hapësirë që synon të nxisë aksesueshmërinë, ndërveprimin social dhe ndërgjegjësimin për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në hapësirat publike. Kjo iniciativë u mundësua falë mbështetjes së individëve dhe bizneseve në eventin Rrathë Dhurues Shqipëri 2025.



“Krijuesit e rinj korçarë të së ardhmes”, iniciativë e mbështetur përmes Rrathë Dhurues 2025, po mbështet të rinj të talentuar përmes mentorimit, trajnimeve dhe mbështetjes me mini-grante, për të zhvilluar prototipet e tyre në fusha si teknologjia, energjia, mjedisi, bujqësia dhe siguria.

“

Për ne si organizatë e re ishte një mundësi e shkëlqyer të ishim një nga tre iniciativat e përzgjedhura për eventin “Rrathë Dhurues 2025”.

Jo vetëm që patëm mundësinë të paraqisnim iniciativën tonë MALGA para publikut atje dhe të krijojmë një fond fillestar, por ky aktivitet na ndihmoi të arrinim një audiencë edhe më të gjerë.

Jemi mirënjohës për mundësinë që Partnerët Shqipëri krijoi për ne dhe për mbështetjen e vazhdueshme që ka treguar. Faleminderit!

Majlinda Hoxha
Network Albania



DËSHMI TË PËRFITUESVE TANË



Përmes iniciativës **MALGA** – **Mal, Gurë, Ajër** dhe falë mbështetjes së siguruar gjatë eventit Rrathë Dhurues 2025 po rikthehet gjelbërimi në Parkun Kombëtar Lurë-Mali i Dejës. Përmes metodës Fukuoka janë mbjellë rreth 5,200 toptha dhe me fara bredhi, duke hedhur bazat për një proces afatgjatë rigjenerimi të zonës.




Takimi vjetor i ECFI-së, zhvilluar më 24–25 nëntor në Vjenë, ku organizata mbështetëse të fondacioneve komunitare nga e gjithë Evropa shkëmbyen përvoja, forcojnë partneritetet dhe reflektojnë mbi rolin e filantropisë komunitare në një kontekst social dhe demokratik në zhvillim. Takimi u fokusua në zhvillimet kryesore të vitit 2025, përfshirë pjesëmarrjen e të rinjve, ndryshimet klimatike, reagimin ndaj emergjencave dhe ndërtimin e kapaciteteve lokale, si dhe në përcaktimin e prioritetëve për vitin 2026, duke shënuar njëkohësisht 10-vjetorin e ECFI-së.

ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE RRETH AKTIVITETIT FILANTROPIK DHE INFRASTRUKTURËS MBËSHTETËSE




Raporti Kombëtar “Fondacionet Komunitare në Shqipëri” paraqet vlerësimin e parë të thelluar mbi krijimin e fondacioneve komunitare, me një fokus të veçantë në modelin e parë të krijuar në vend, duke analizuar sfidat, mundësitë dhe potencialin e tyre për zhvillimin lokal. (I disponueshëm në gjuhën angleze).



“Philanthropy” është një revistë e cila pasqyron çështje të ndryshme rreth nismave dhe zhvillimeve të aktivitetit filantropik në Shqipëri.



Kontribut në hartimin e Profilit të Shqipërisë mbi kuadrin ligjor dhe fiskal të filantropisë, pjesë e bashkëpunimit me Shoqatën Evropiane të Filantropisë (Philea-n).



Kontribut në hartimin e raportit kombëtar për Shqipërinë, në kuadër të Indeksit Global të Mjedisit të Filantropisë 2025 (GPEI).



Takimi rajonal i zhvilluar më 22 tetor në Shkup, organizuar nga European Community Foundation Initiative (ECFI) dhe Konekt, i cili mbledhi drejtues të fondacioneve komunitare dhe organizatave mbështetëse nga Ballkani për të diskutuar forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij modeli në rajon.

ADVOKIM DHE PUNË KËRKIMORE PËR NJË QEVERISJE TRANSPARENTË DHE TË PËRGJEGJSHME



Analizë dhe Rekomandime për Strategjinë Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën Publike 2024-2030.



Analizë dhe Rekomandime lidhur me projektligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.



Analizë dhe Rekomandime për Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030, dhe Planit të Veprimit 2026 – 2028.




Raporti i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve në Shqipëri për vitin 2024, i realizuar në bashkëpunim me organizatën Përtej Barrierave.



Partnerët Shqipëri dhe UNICEF Shqipëri nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi (MoU) për avancimin e të drejtave të fëmijëve, fuqizimin e hapësirës qytetare dhe qeverisje transparente. Bashkëpunimi përqendrohet në dialog politik të bazuar në evidencë, mobilizim burimesh për fëmijët e të rinjtë, dhe mbështetje për reforma gjithëpërfshirëse e llogaridhënës, në kuadër të Planit të Rritjes 2024–2030 për Ballkanin Perëndimor dhe iniciativave si European Child Guarantee dhe Youth Guarantee.

PUNA JONË NË MEDIA



PROJEKTI

DONATORI

Për një treg pune në dobi të rinisë shqiptare - RISI ALBANIA

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Challenge Fund | EU4Innovation, Faza II 2022-2026

TWIST - Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri

Përmirësimi i Aktivitetit Filantropik dhe Infrastrukturës Mbështetëse në Shqipëri

Mbrojtja e Hapësirës Qytetare - Hub-i Rajonal për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Invest for Change - I4C

Civil Society Engagement in Public Budgeting Processes

CREASSE – Nxitja e Ekonomisë Sociale dhe Solidare Gjithëpërfshirëse në Zonat Rurale (2024-2026)

Tranzicioni i dyfishtë për Sipërmarrjet Sociale në Sektorin e Artit dhe Artizanatit” (TtraSE)

Ekonomia Qarkulluese për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

Bashkimi Evropian

Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (SIDA) dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

Bashkimi Evropian përmes Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri

Rockefeller Brother Funds

Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (SIDA) përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Bashkimi Evropian

International Budget Partnership


Komisioni Evropian / Erasmus +

Komisioni Evropian / Erasmus +

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH / Komisioni Evropian



Funded by the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



Sweden

Sverige



Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World



Sida
SWEDISH INTERNATIONAL DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY



Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



PARTNERSGLOBAL
Together for Democratic Change



HELVETAS
ALBANIA



Balkan Civil Society Development Network



Erasmus+



balkan green foundation



CREDINS BANK



ensie
EUROPEAN NETWORK OF SOCIAL INCLUSION ENTERPRISES



Impact Europe



diesis network



EUROPEAN COMMUNITY FOUNDATION INITIATIVE



WINGS
ELEVATING PHILANTHROPY




BEYOND BARRIERS
We believe in what we do.




Akademia e Integritetit Evropian dhe Negociatave



International Budget Partnership



Buxheti për vitin fiskal 2025 200,100,105 Lekë




Qeveri të huaja



Shërbime me pagesë



Fondacione private



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate,
kati i 10-të, Ap. 71 / 73, Kutia Postare 2418/1,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355697889600 | +355 42254881

Email: partners@partnersalbania.org

Web: <http://www.partnersalbania.org>

